



Lajmet e Fundit: Vlorë – Vihet në pranga 1 shtetas i shpallur në kërkim



LajmetOperacionet

12/12/2021

Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Bujtina”, për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve dhe armëmbajtjes pa leje

Operacioni nga Komisariati i Policisë Nr. 6.

Kishte përshtatur lokalin për përdorim dhe shitje të lëndës narkotike kokainë, vihet në pranga pronari i tij.

Sekuestrohen një armë zjarri pistoletë, një sasi kokaine, fishekë luftarakë, një peshore elektronike dhe dy armë të ftohta (thika).

Në vijim të punës për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e shpërndarjes së lëndëve narkotike, bazuar në informacionet e grumbulluara në rrugë operative se një shtetas kishte përshtatur lokalin në pronësi të tij për përdorim droge dhe se mbante armë zjarri dhe armë të ftohta në banesë, specialistët për Hetimin e Krimeve pranë Komisarariatit të Policisë Nr. 6 Tiranë, kanë finalizuar operacionin policor “Bujtina”, në kuadër të të cilit u vu në pranga shtetasi:

L. E., 42 vjeç, banues në Tiranë.

Ky shtetas kishte përshtatur lokalin në pronësi të tij për shitje dhe për përdorim të lëndëve narkotike kokainë.

Në vijim të veprimeve, gjatë kontrollit të lokalit dhe të banesës së tij, janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një armë zjarri e llojit pistoletë dhe fishekë luftarakë, një sasi lënde narkotike kokainë, një peshore elektronike që shërbente për peshimin e lëndës narkotike dhe dy armë të ftohta (thika).

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprime të mëtejshme.



Share



Share



Share



Share



Email

◀ Policia e Shtetit – Vijon monitorimi i qarkullimit rrugor nga makina inteligjente

Shkodër – Vijon operacioni policor i koduar “Fati i lojrave” ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



GET IT ON

Google Play



Download on the
App Store

Arkiva

Select Month



Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)